



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

RELACION

Mbi

RAPORTIN E MONITORIMI TË ZBATIMIT TË BUXHETIT PËR VITIN 2022

Në zbatim të ligjit 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", plani i buxhetit për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë është miratuar në vlerën 47.471.725.000 lekë, sipas zërave:

- Shpenzime korrente 5.153.656.000 lekë
 - Shpenzime kapitale 42.318.069.000 lekë
- nga të cilat:*
- shpenzime kapitale me financim të brendshëm 25.374.314.000 lekë
 - shpenzime kapitale me financim të huaj 16.943.755.000 lekë

Plani i buxhetit për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, gjatë vitit pësoi ndryshime në kuadër të rishikimit të buxhetit:

1. me Aktin Normativ nr.3, datë 12.03.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022",
 - Shpenzimet korrente, u pakësuan në vlerën 351.604.000 lekë,
 - Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, u pakësuan në vlerën 1.232.000.000 lekë,
 - Shpenzimet kapitale me financim të huaj, u pakësuan në vlerën 2.900.000.000 lekë.
2. me Aktin Normativ nr.12, datë 29.07.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022",
 - Shpenzimet korrente, u shtuan në vlerën 184.000.000 lekë,
 - Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, u pakësuan në vlerën 400.000.000 lekë,
 - Shpenzimet kapitale me financim të huaj, u shtuan në vlerën 2.600.000.000 lekë.
3. me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022",
 - Shpenzimet korrente, u shtuan në vlerën 2.817.180.000 lekë,
 - Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, u shtuan në vlerën 8.143.925.000 lekë,
 - Shpenzimet kapitale me financim të huaj, u pakësuan në vlerën 6.032.000.000 lekë.

4. me Aktin Normativ nr.19, datë 29.12.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022",
 - Shpenzimet kapitale me financim të huaj, u pakësuan në vlerën 1.770.000.000 lekë.
5. VKM nr.498, datë 29.07.2022 "Për kalim fondi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për mbështetjen e Sektorit Energjitik",
 - Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, u shtuan në vlerën 8.000.000.000 lekë.
6. VKM nr.603, datë 14.09.2022 "Për kalim fondi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për mbështetjen e Sektorit Energjitik",
 - Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, u shtuan në vlerën 8.000.000.000 lekë.
7. VKM nr.875, datë 27.12.2022 "Për kalim fondi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për mbështetjen e Sektorit Energjitik",
 - Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, u shtuan në vlerën 4.000.000.000 lekë.

Gjithashtu, plani i buxhetit pati ndryshim dhe si rezultat i alokimit të fondit të veçantë prej 4.550.000 lekë.

Plani fillestar i buxhetit, plani i rishikuar dhe realizimi faktik për vitin 2022, sipas programeve buxhetore, paraqitet si më poshtë:

në mijë lekë

Kod Programi	Programi	Plani Fillestar 2022	Plani i rishikuar 2022	Realizimi faktik 2022
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	523.224	545.518	535.617
04520	Transporti Rrugor	24.021.155	26.771.139	27.407.512
04540	Transporti Detar	199.400	142.573	134.987
04550	Transporti Hekurudhor	2.772.349	2.611.550	2.532.410
04560	Transporti Ajror	92.312	2.087.093	2.085.262
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	14.241.859	10.607.876	10.047.310
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	1.743.042	1.217.042	1.513.699
04320	Mbështetje për Energjinë	3.035.495	23.822.218	21.781.154
04430	Mbështetje për Burimet Natyrore	315.385	402.141	398.309
04440	Mbështetje për Industrinë	341.160	325.616	318.403
04610	Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit	24.000	1.000	-
06180	Planifikimi Urban	162.343	101.402	96.635
	TOTALI	47.471.725	68.635.168	66.851.300

Realizimi i fondeve buxhetore sipas zërave përbërës të shpenzimeve paraqitet si më poshtë:

në mijë lekë

Kod Programi	Emertimi Programi	Shpenzime Korrente	Shpenzime Kapitale	
			me Financim të Brendshëm	me Financim të Huaj
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	465.664	69.953	-
04520	Transporti Rrugor	3.375.849	20.552.957	3.478.706
	<i>Projekte koncesionare/PPP</i>		4.074.075	
	<i>Projekte të infrastrukturës rrugore/ARRSH</i>		16.478.882	
04540	Transporti Detar	97.737	34.083	3.167
04550	Transporti Hekurudhor	515.214	394.327	1.622.870
04560	Transporti Ajror	2.009.031	76.232	-
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	425.898	8.428.226	1.193.186
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	179.722	545.262	788.715
04320	Mbështetje për Energjinë	126.494	21.514.678	139.982
04430	Mbështetje për Burimet Natyrore	261.415	136.894	-
04440	Mbështetje për Industrinë	267.596	50.807	-
04610	Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit	-	-	-
06180	Planifikimi Urban	54.580	42.055	-
	TOTALI	7.779.200	51.845.474	7.226.626

Sqarojmë se në zbatim të VKM nr.111, datë 02.03.2022 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, MIE i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresat nr.2362, datë 11.03.2022, nr.2362/1, datë 06.04.2022 dhe nr.5491/1, datë 19.07.2022 për programin “Menaxhimi i Mbetjeve Urbane”, i cili nuk është në fushën e përgjegjësisë së MIE. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, fondet buxhetore për investime me financim të brendshëm i ka çelur si fonde të ngrira, ndërsa fondet për TVSH janë çelur për financimin dhe rimbursimin e faturave të projekteve me financim të huaj.

Performanca dhe statusi i produkteve kryesore

PROGRAMI “PLANIFIKIM MENAXHIM ADMINISTRIM”

Fondet buxhetore në zbatim të këtij programi shkojnë për realizimin e qëllimit dhe arritjen e objektivave të politikës së programit me qëllim funksionimin dhe forcimin e kapaciteteve administrative të Aparatit të Ministrisë, rritjen e standardeve dhe performancës së punës së punonjësve.

Në vitin 2022, janë realizuar gjithsej 14 angazhime auditimi, nga të cilat 6 auditime financiare dhe 7 auditimi të përputhshmërisë, nga të cilat 3 prej tyre janë inicuar nga Ministri dhe një auditim për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi.

Shpenzimet Korrente

- *Paga dhe sigurime*, plani i rishikuar i vitit 2022 prej 278.6 milion lekë është realizuar në vlerën 278.6 milion lekë ose 100%.
- *Shpenzime operative*, plani i rishikuar i vitit 2022 prej 110.5 milion lekë është realizuar në vlerën 110.4 milion lekë ose 100%.
- *Transferrat korrente të huaja*, plani i rishikuar i vitit 2022 prej 27.7 milion lekë është realizuar në vlerën 27.7 milion lekë ose 100%, pagesa të cilat janë realizuar për IMO, UPU, IRENA, ICOLD, ITU, TCT, Energy Community, OTIF, ALVCOLD dhe CEPT.
- *Transferrat për Buxhetin Familjar dhe Individual*, plani i rishikuar i vitit 2022 prej 48.9 milion lekë është realizuar në vlerën 48.9 milion lekë ose 100%. Për shkak të numrit të lartë të personave që kanë depozituar dokumentacionet përkatëse janë likujduar 600 praktika për vitin 2021 dhe janë në proces 1520 dosje nga viti 2021 dhe viti 2022 të cilat nuk janë likujduar pasi fondi i miratuar nuk mund ti mbulojë këto shpenzime. Dosjet të cilat janë rregjistruar për vitin 2022 nuk janë likujduar për shkak të problematikave që kanë si dhe për shkak të mungesës së fondeve për të mbuluar këto shpenzime.

Shpenzimet Kapitale me financim të brendshëm

Buxheti i vitit 2022, për investimet me financim të brendshëm, për këtë program është planifikuar në shumën 13 milion lekë.

Sipas projekteve ai paraqitet :

- “Blerje pajisje zyre”, është planifikuar në vlerën 834.000 lekë dhe realizimi financiar është 596.160 ose në masën 71.5%.
- “Sistem i mbikqyrjes me kamera nga jashtë godinës nr.2”, është planifikuar në vlerën 1.000.000 lekë dhe nuk është realizuar, do të likujdohen në vitin 2023 pasi faturat janë depozituar me vonësë pranë Sektorit të Financës.
- “Instalimi i sistemit të qarkullimit të ajrit në magazinën e godinës nr.2” është planifikuar në vlerën 1.500.000 lekë dhe realizimi financiar është 1.497.600 lekë ose në masën 100%.
- “Blerje pajisje elektrike pc, fotokopje etj” është planifikuar në vlerën 5.782.700 lekë dhe realizimi financiar është 5.782.680 lekë ose në masën 100%.

Nga Fondet e Rindërtimit në zbatim të VKM nr.771, datë 15.12.2021 “Për përdorimin e fondit të Rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të godinës e Institutit të Ndërtimit dhe caktimin e Institutit të Ndërtimit si njësi zbatuese”, për financimin e rikonstruksionit të godinës së Institutit të Ndërtimit u trashëguua fondi nga viti 2021 prej 13.786.083 lekë dhe për vitin 2022 u alokua fondi prej 55.144.33 lekë, nga i cili u realizua 60.367.495 lekë ose në masën 87.6%. Diferenca e fondit të papërdorur prej 7.536.494 lekë, do të kërkohej të transferohet në vitin 2023.

Gjithashtu për vitin 2022, në zbatim të VKM nr.29, datë 19.05.2021 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të palujtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier”, u alokua diferenca në vlerën 1.709.700 lekë nga vlera totale prej 20.892.266 lekë, nga i cili për vitin 2021 u realizua 19.182.988 lekë. Realizimi financiar është 1.709.278 lekë ose në masën 100%.

Sqarojmë se detyrimet e prapambetura për vitin 2022 për Aparatin e MIE, janë si më poshtë :

1. Vendime Gjyqësore	1.442.357.634 lekë
2. Detyrime të prapambetura për shërbime	614.211 lekë
3. Detyrime për rimbursim TVSH	9.304.090 lekë
4. Detyrime për Invesime	593.632 lekë

Detyrimet e prapambetura për vitin 2022 në vlerën **1.452.869.567 lekë** janë krijuar si pasojë e mungesës së fondeve të nevojshme për ti likujduar këto detyrime.

Detyrimet e prapambetura për vendimet gjyqësore të formës së prerë janë vendime të cilat kanë lindur si detyrime prej vitit 2011 dhe janë likujduar rast pas rasti.

PROGRAMI “TRANSPORTI RRUGOR”

Treguesit vjetor buxhetor për programin "Transporti Rrugor", janë realizuar:

- Plani vjetor 2022, i rishikuar në vlerën 26,771,139,000 lekë
- Realizimi financiar vjetor, në vlerën 27,407,512,000 lekë, ose 103%

Shpenzimet Korrente

Plani vjetor i shpenzimeve korrente, në vlerën 3,385,844,000 lekë, është realizuar në vlerën 3,375,849,000 lekë, ose 99,7%, sipas zërave:

- Shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime shoqërore), në vlerën 3,382,766,000 lekë, është realizuar në vlerën 3,373,141,000 lekë, ose 100%.
- Shpenzimet operative, në vlerën 3,221,275,000 lekë, janë realizuar në vlerën 3,212,456,000 lekë, ose 100%, për shpenzimet administrative të institucioneve buxhetore si dhe për financimin e kontratave të mirëmbajtjes rrugore në proces zbatimi.
- Shpenzimet për fondin e veçantë në vlerën 2,808,000 lekë, janë realizuar në vlerën 2,708,000 lekë, ose 96%.

Gjatë vitit 2022, buxheti i shpenzimeve korrente në nivel programi pësoi ndryshime buxhetore shtesa/pakësime si vijon :

- Me Aktin Normativ nr.3, datë 12.03.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2022", shpenzimet korrente, zëri shpenzimeve operative për kontratat e mirëmbajtjes, u pakësua në vlerën 266,761,000 lekë
- Me Aktin Normativ nr.12, datë 29.07.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2022" shpenzimet korrente u shtuan në vlerën 33,000,000 lekë.
- Me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"", të ndryshuar, shpenzimet operative u shtuan me 800,000,000 lekë, për likuiduar të gjitha detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi deri në fund të vitit 2022, për menaxhimin e kontratave të mirëmbajtjes.
- Me Aktin Normativ nr.19, datë 29.12.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"", të ndryshuar, si dhe VKM-në nr. 898, datë 29.12.2022, "Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës", shpenzimet e personelit për paga dhe sigurime shoqërore janë pakësuar në vlerën 2,290,000 lekë, për të planifikuar fonde për ndihmën e menjëhershme financiare, sipas njësive shpenzuese të programit.

Shpenzimet Kapitale me Financim të Brendshëm

Plani vjetor shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, për vitin 2022, në vlerën 20,575,163,000 lekë, realizimi financiar në vlerën 20,552,957,000 lekë ose 99,9 % e realizuar.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, gjatë vitit 2022, kanë pësuar ndryshime buxhetore shtesa/pakësime si vijon:

- Me Aktin Normativ nr.3, datë 12.03.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2022", shpenzimet kapitale me financim të brendshëm u reduktuan në vlerën 600,000,000 lekë.
- Me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"", të ndryshuar, shpenzimet kapitale me financim të brendshëm u shtuan në vlerën 5,000,000,000 lekë, për financimin e projekteve të infrastrukturës rrugore.

Gjatë vitit 2022, MIE ka realizuar financimin e projekteve koncesionare dhe të investimeve të infrastrukturës rrugore, të cilat janë realizuar në masën 100%, për:

- Projekti "Ndërtim, operim, mirëmbajtje rruga e Abrit",
- Projekti "Ndërtim operim, mirëmbajtje rruga Milot – Morinë",
- Projekti "Ndërtim, operim, mirëmbajtje rruga Orikum – Dukat- Ura e Shën Elizës",
- Projekti "Ndërtim Tuneli i Llogarasë".

Për projektet me financim të brendshëm që zbatohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, për vitin 2022, u zbatuan dhe u financuan projektet e infrastrukturës rrugore, sipas kontratave dhe grafikut të punimeve. Nga të dhënat "Raporti i realizimit të produkteve dhe i shpenzimeve faktike të programit sipas produkteve", rezulton se:

Grupi i produktit "Ndërtim Rruge" i shprehur në sasi (km) për 12 mujorin e vitit 2022, është parashikuar 79.66 km, e cila është realizuar 79.66 km. Shpenzimeve faktike për këtë produkt të planifikuar në vlerën 8,564,977,000 lekë, janë realizuar në vlerën 8,564,447,000 lekë ose 99,9%. Produktet e shprehur në terma sasiorë (km) sipas tipeve të ndërtimit të rrugëve (tip A2 me katër korsi, A2' 2x2 me trotuare dhe ndriçim, B1' me dy korsi, C2 dhe me dy korsi), të planifikuar për 12 mujorin e vitit 2022, paraqitet:

PLANIFIKUAR

A2 me standartet e reja - 4.08 km
 A e modifikuar - 1.55 km
 A2' - 0.93 km
 B1' - 33.3 km
 C2 - 39.8 km

FINANCUAR

4.08 km ose 100% e planit
 1.55 km ose 100% e planit
 0.93 km ose 100% e planit
 33.3 km ose 100% e planit
 39.8 km ose 100% e planit

Ndërtim rruge tip A me katër korsi (2x2) sipas Standarteve të Reja. Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerën 2,768,443,000 lekë (32% ndaj planit total vjetor grupi i produktit "Ndërtim rruge") dhe në sasi 4,08 km. Buxheti i shpenzimeve të këtij grup produkti, është në vlerën 2,768,404,000 lekë ose 100% e buxhetit të planifikuar. Përfshihen në këtë grup projektet rrugore:

- Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 1, Loti 2, Loti 3;
- Ndërtim rruga mbikalimi Teg dhe rrugët lidhëse të tij;
- Ndërtim i Unazës së Jashtme Tiranë, Loti 4;
- Ndërtim i Unazës së jashtme Tiranë, Loti 5;
- Ndërtim i Unazës së jashtme Tiranë, Loti 6;
- Ndërtim i Unazës së jashtme Tiranë, Loti 7;
- Plotësimi i punimeve dhe rrugët lidhëse në Unazën lindore, Loti 2;
- Plotësimi, Rakordimi dhe vazhdimi i punimeve Sheshi Shqiponja – Lumi i Tiranës, Loti 1 dhe QMT;
- Ndërtim i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja – Bulevardi i ri, Loti 2.

Ndërtim rruge tip A2' 2x2 me trotuare dhe ndriçim. Për këtë grup produkti, janë planifikuar fonde vjetore në vlerën 672,680,000 lekë (7.8% ndaj planit të përgjithshëm vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim Rruge") dhe në sasi 0.93 km. Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produkti, është 672,680,000 lekë ose 100% e buxhetit të planifikuar dhe në km janë realizuar 0.93 km ose 100 % e sasisë së planifikuar. Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tip rruge me katër korsi dhe gjërësi që varion nga 24-25 m, me disa objekte të rëndësishëm që janë në proces si:

- Përfundim i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore nyja e Milotit;
- Ndërtim i unazës së Jashtme Tiranë pjesa verilindore (seg Kth Saukut-Bregu i lumit) Loti 2;
- Rikualifikim i akseve rrugore Unaza Lindore Loti 2, Loti 3;
- Ndërtim rruga By Pass Perëndimor Shkodër, Loti 1 + shtesë punimesh.

Ndërtim rruge tip B1' me dy korsi. Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 1,442,766,000 lekë, ose 16.8 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim rrugë") dhe në sasi 33.3 km. Realizimi i shpenzimeve të këtij grupi produkti në vlerën 1,442,766,000 lekë ose 100% e buxhetit të planifikuar dhe në km janë realizuar 33.3 km ose 100% e sasisë së planifikuar. Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tipe rruge me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 10-17 m, siç mund të përmendim projektin "Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 4, shtesë punimesh, Loti 7 dhe Loti 8 dhe shtesë punimesh".

Ndërtim rruge tip C2 me dy korsi. Për tipin e rrugës C2, janë planifikuar fonde në vlerën 3,374,921,000 lekë ose 39,4% ndaj planit vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim rruge) dhe në sasi 39.8 km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës C2 është në vlerën 3,374,430,000 lekë ose 99.9 % e buxhetit të planifikuar dhe në sasi 39.8 km ose 100% e sasisë së planifikuar. Janë përfshirë kryesisht tipe rruge C2, me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 7.5-10 m.

Projektet që janë në process zbatimi, përmendim :

- Ndërtim By Pass Tepelenë Loti 1, shtesë punimesh;
- Ndërtim rruga Korçë – Ersekë, Loti 2 (pjesa e parë) dhe pjesa e dytë;
- Ndërtim rruga Palasë – Dhërmi;
- Rikonstrukcion i rrugës Dukaj - Sinanaj, Tepelenë;
- Ndërtim i rrugës, lidhja e Autostradës Milot - Morinë me Aeroportin e Kukësit;
- Rehabilitim i segmentit rrugor Levan - Vlorë (rruga e vjetër).
- Rikonstrukcion i aksit rrugor Maliq - Lozhan i Ri Strelcë;
- Zgjerimi i rruges Elbasan - Qafë - Thanë (Faza I);
- Ndërtim i rrugës së Fushë - Bardhës, lidhja me rrugën Kardhiq – Delvinë;
- Ndërtimi i rrugës së fshatit Senicë dhe lidhja me rrugën Kardhiq – Delvinë;
- Ndërtim i lidhjes së rrugës së Oroshit me rrugën e Kombit,
- Përfundimi i punimeve në segmentet rrugore ura e Kranesë Qafë Botë, Ura e Kranesë Ura e Gajdarit dhe përmirësimi i segmentit rrugor Shijan Ura e Gajdarit;
- Ndërtim rruga lidhëse e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA) - Autostrada Fier Vlorë.

Ndërtim rruge A e modifikuar. Ky tip rruge përfaqëson një aks rrugor autostradë me katër vija kalimi 4 x3.75 m dhe me dy bankina të asfaltuara me gjerësi 2 x 3 m, si dhe dy bankina të paasfaltuara me gjerësi 2 x1.5 m, së bashku dhe me trafik ndarësen e mesit, gjerësia e trupit të rrugës është 28m.

Për tipin e rrugës A e modifikuar, janë planifikuar fonde në vlerën 306,167,000 lekë ose 3.6% ndaj planit vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim rrugë) dhe në sasi 1.55 km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës A e modifikuar është në vlerën 306,167,000 lekë, e cila është realizuar në sasinë 1.55 km ose 100% e sasisë së planifikuar, në projektin

- Ndërtim rruga Porto Romano Durrës, Loti 3.

Sinjalistikë dhe Siguri Rrugore. Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerën 548,207,000 lekë (ose 100% ndaj planit vjetor (Grupi i produktit "Sinjalistikë rrugore) dhe në sasi 474.3 km. Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produkti është 547,850,000 lekë, ose 99.93 km, ku përfshihen projektet :

- Eliminim i pikave të zeza (Black Spots), në rrjetin rrugor kombëtar;
- Përmirësim i sinjalistikës horizontale në akset dhe segmentet rrugore të Rajonit Qëndror;
- Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore, në akset e Rajonit Verior, LOTI 1 (2022)
- Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore, në akset e Rajonit Qëndror, LOTI 2 (2022)
- Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Jugor, LOTI 3 (2022)

Ura dhe Emergjencia. Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerën 88,229,453 lekë (100% ndaj planit vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim urash"). Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produkti është 88,228,581 lekë ose 100%. Në këtë zë janë përfshirë dhe fondet e akorduara për Autoritetin Rrugor Shqiptar, nga Fondi i Rindërtimit, në vlerën 3,276,780 lekë për "Rindërtimin e Urës së Tapizës", e dëmtuar nga pasojat e tërmetit 2019. Në këtë grup projektsh përfshihen:

- Rindërtim i Urës së Tapizës;
- Rikonstruksion i Urës së Vorës;
- Emergjencë mbrojtje lumore Ura e Drojës.

Grupi i shpenzimeve për "**Shpronësime**" dhe "**Vendime gjyqësore**", i detajuar paraqitet si vijon:

	PLANIFIKUAR	FINANCUAR
• Vendime gjyqësore	180,000,000 lekë	179,999,999 lekë ose 100%
• Shpronësime	404,804,770 lekë	404,804,770 lekë ose 100%

Shpenzimet kapitale për **TVSH dhe Kosto Lokale**, në total janë planifikuar në vlerën 1,086,061,369 lekë ose 10% ndaj planit vjetor) dhe janë financuar si vijon:

- Kosto Lokale, plani 364,223,192 lekë, realizimi financiar 353,145,138 lekë ose 97 %;
- TVSH e Taksë doganore, plani 721,838,177 lekë, realizimi financiar 715,986,380 lekë ose 99%;

Lidhur me detyrimet e prapambetura si dhe ato të krijuara rishtazi gjatë vitit 2022, Autoriteti Rrugor Shqiptar informon se mbyllja e vitit buxhetor 2022, ka rezultuar pa detyrime të prapambetura në të gjithë zërat buxhetore, vetëm në zërin "Vendime Gjyqësore" rezulton detyrim i prapambetur në vlerën 335,297,976 lekë, për shkak të paraqitjes së vendimeve gjyqësore të formës së prerë, pranë institucionit.

Shpenzimet Kapitale me Financim të Huaj

Plani vjetor i rishikuar i shpenzimeve kapitale me financim të huaj 2022, në vlerën 2,810,132,000 lekë, është realizuar në vlerën 3,478,706,000 lekë ose 124% e realizuar.

Shpenzimet kapitale me financim të huaj, gjatë vitit 2022, kanë pësuar ndryshime buxhetore shitesa/pakësime si vijon:

- Me Aktin Normativ nr.3, datë 12.03.2022 "Për disa shitesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2022", shpenzimet kapitale me financim të huaj, u reduktuan në vlerën 450,000,000 lekë.
- Me Aktin Normativ nr.12, datë 29.07.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"", të ndryshuar, shpenzimet kapitale me financim të huaj, u shtuan në vlerën 1,400,000,000 lekë.
- Me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"", të ndryshuar, shpenzimet kapitale me financim të huaj, u reduktuan në vlerën 1,400,000,000 lekë.
- Me Aktin Normativ nr.19, datë 29.12.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"", të ndryshuar, shpenzimet kapitale me financim të huaj, u reduktuan në vlerën 1,770,000,000 lekë.

Për shpenzimet kapitale me financim të huaj, sipas kategorive të rrugëve tipi B, tipi C dhe Kategoritë ndryshme (Mirëmbajtja), janë planifikuar 1,350 km dhe janë realizuar 1,342 km ose 99,1%. Realizimi i produkteve dhe i shpenzimeve për vitin 2022, paraqitet si vijon:

PLANIFIKUAR		FINANCUAR
Kategoria B,	4 km	5.41 km ose 135 %
Kategoria C,	4 km	3.9 km ose 97.5%
Ndërtim Rruge	1333 km	1333 km ose 100 %

PROGRAMI “TRANSPORTI DETAR”

Treguesit buxhetorë vjetor për programin "Transporti Detar", janë realizuar:

- Plan vjetor 2022, i rishikuar në vlerën 142,572,500 lekë
- Realizimi financiar vjetor, në vlerën 134,990,022 leke ose 94%

Shpenzimet Korrente

Plan vjetor i rishikuar i shpenzimeve korrente, në 99,572,500 lekë, është realizuar në vlerën 97,736,822 lekë, ose 98%, sipas zërave:

- Shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime shoqërore), në vlerën 83,005,000 lekë, është realizuar në vlerën 82,815,145 lekë, ose 100%.
- Shpenzimet operative, në vlerën 15,716,000 lekë, janë realizuar në vlerën 14,124,177 lekë, ose 90%, për shpenzimet administrative të institucioneve buxhetore si dhe për financimin e kontratave të mirëmbajtjes rrugore në proces zbatimi.
- Shpenzimet për fondin e veçantë në vlerën 77,500 lekë, janë realizuar në vlerën 77,500 lekë, ose 100%.

Gjatë vitit 2022, buxheti i shpenzimeve korrente në nivel programi pësoi ndryshime buxhetore shtesa/pakësime si vijon :

- Me Aktin Normativ nr.3, datë 12.03.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2022", shpenzimet korrente, zëri shpenzime personeli si dhe shpenzime operative, u pakësua në vlerën 3,965,000 lekë,
- Me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"", të ndryshuar, zëri shpenzime personeli , u pakësua në vlerën 6,000,000 lekë.
- Në VKM-në nr. 898, datë 29.12.2022, "Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës", shpenzimet e personelit për paga dhe sigurime shoqërore janë pakësuar në vlerën 670,000 lekë, si dhe është shtuar vlera 730,000 leke , për të planifikuar fonde për ndihmën e menjëhershme financiare, sipas njësive shpenzuese të programit.

Shpenzimet Kapitale me Financim të Brendshëm

Plani vjetor i rishikuar i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj, në vlerën 43,000,000 lekë, është realizuar në vlerën 37,253,200 lekë, ose 87%.

- Plani vjetor i rishikuar i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, në vlerën 35,000,000 lekë, është realizuar në vlerën 34,083,481 lekë, ose 98%.
- Plani vjetor i rishikuar i shpenzimeve kapitale me financim të huaj, në vlerën 8,000,000 lekë, është realizuar në vlerën 3,169,719 lekë, ose 40%.

Gjatë vitit 2022, buxheti i shpenzimeve kapitale në nivel programi pësoi ndryshime buxhetore shtesa/pakësime si vijon:

- Me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", zëri shpenzime kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj, u pakësua në vlerën 47,000,000 lekë.

Sipas projekteve ai paraqitet :

- "Konservimi i ndërmarrjes së kontrollit të shfrytëzimit të mjeteve ujore Vau i Dejës" është planifikuar në vlerën 3.778.000 lekë dhe është realizuar 3.775.626 lekë ose në masën 100%.
- "Rikonstruktion i godinës së DPD" është planifikuar në vlerën 5.060.211 lekë dhe realizimi financiar është 5.059.875 lekë ose në masën 100%.
- "Rikonstruktion i kalatës së RORO" është planifikuar në vlerën 15.985.100 lekë dhe realizimi financiar është 15.985.100 lekë ose në masën 100%.
- "Rikonstruktion i Terminalit të Pasagjerëve Sarandë" është planifikuar në vlerën 2.000.000 lekë dhe realizimi financiar është 2.000.000 lekë ose në masën 100%.
- "Ndërtimi i hyrjes së Portit Detar Sarandë" është planifikuar në vlerën 4.000.000 lekë dhe realizimi financiar është 3.992.000 lekë ose në masën 100%.
- "Vazhdimi i sinjalit satelitor LRIT" është planifikuar në vlerën 1.345.300 lekë dhe realizimi financiar është 579.128 lekë ose në masën 43% dhe është projekt në vazhdim.
- "Tvsh për projektin e asistencë-teknike për monitorimin, komunikimi i kontrates sektoriale" është planifikuar në vlerën 400.000 lekë dhe realizimi financiar është 344.058 lekë ose në masën 86%.
- Supervizion "Projektimi dhe ndërtimi i Portit të Integruar Vlorë", u çel fond i ngrirë dhe do vijojë në vitin 2023.
- "Blerje pajisje navigacionale për Kapiteneritë Durrës, Vlorë, Sarandë" është planifikuar në vlerën 144.000 lekë dhe është realizuar 144.000 lekë ose në masën 100% dhe do të vijojë edhe për vitin 2023.
- "Tvsh - Shperndarja e pajisjeve Sistemit Automatik të Identifikimit" është planifikuar në vlerën 2.287.300 lekë dhe realizimi financiar është 2.203.694 lekë ose në masën 96%.

Shpenzimet Kapitale me financim të huaj, janë planifikuar në shumën 8,000,000 lekë dhe realizimi financiar është në vlerën 3,167,000 lekë ose 40% për projektet:

1. **Projekti “MEDEA”** me grand i financuar 100% nga BE, pa detyrime bashkëfinancimi, dhe ka një vlerë totale 65 000 euro (mbulon shpenzimet e udhëtimit dhe kostot e stafit). Për vitin 2022 është planifikuar në vlerën 1,6 milion lekë dhe ka realizim në vlerën 1.1 milion lekë.

2. **Projekti “BLUWBC DP Detare”** projekt i financuar 90% nga BE dhe 10 % nga buxheti i shtetit. Ky projekt ka një vlerë totale prej 9.922 euro. Për vitin 2022 është planifikuar në vlerën 1,9 milion lekë dhe ka realizim në vlerën 1.2 milion lekë.

3. **Projekti “MEP & M” (Development of Regional Joint Master Program in Marime Environmental protecon and Management/MEP&M)** i financuar 100% nga Bashkimi European në vlerën 32.316 euro. Për vitin 2022 është planifikuar në vlerën 2.6 milion lekë dhe është relizuar në vlerën 806 mijë lekë.

4. **Projekti “EUREKA”** (“Adriatic-Ionian joint approach for development and harmonisation of procedures and regulations in the field of navigation safety”) lidhur me forcimin e nivelit të sigurisë detare në rajonin Adriatiko-Jonian duke prezantuar një bashkëpunim sistematik dhe koordinim të institucioneve që merren me transportin detar të të gjitha vendeve të rajonit që lagen nga deti Adriatik dhe deti Jon si Italia, Sllovenia, Kroacia, Mali i Zi, Bosnja dhe Greqia. Projekti është i financuar në masën 85% nga BE 183,600.00 Euro dhe 15% nga buxheti i shtetit 32,400.00 Euro. Për vitin 2022 është planifikuar në vlerën 1,7 milion lekë por nuk u realizua për shkak të vonësve nga lead partner në miratimin e termave të referencës.

PROGRAMI “TRANSPORTI HEKURUDHOR”

Prioriteti kryesor në fushën e transportit hekurudhor ka qenë dhe mbetet “Reformimi i sektorit hekurudhor për të krijuar një treg të hapur për publikun dhe investitorët privatë”.

Shpenzimet Korrente

Në këtë program buxhetor janë përfshirë shpenzime për funksionimin e administratës së Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor, në të cilat përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe mallra dhe shërbime, për mbarrëvajtjen e funksionimit të kësaj strukture si dhe subvencionimi i Hekurudhës Shqiptare sh.a.

Gjatë vitit 2022, buxheti i shpenzimeve korrente në nivel programi pësoi ndryshime buxhetore shtesa/pakësime si vijon:

- Me Aktin Normativ nr.3, datë 12.03.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2022", shpenzimet korrente u pakësuan në shumën 1.147.000 lekë.
- Me Aktin Normativ nr.12, datë 29.07.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"", të ndryshuar, shpenzimet korrente u shtuan në shumën 111.000.000 lekë.
- Me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"", të ndryshuar, shpenzimet korrente u pakësuan në shumën 8.001.000 lekë.

Realizimi i shpenzimeve korrente sipas klasifikimit ekonomik, paraqitet si më poshtë:

- Fondi i pagave për DIH , buxheti i rishikuar 9.845.000 lekë dhe realizimi financiar 9.755.000 lekë, ose 99 % e buxhetit 2022.
- Fondi i sigurimeve shoqërore, buxheti i rishikuar 2.218.000 lekë dhe realizimi financiar 1,630.000 lekë, ose 74% e buxhetit 2022.
- Fondi i shpenzimeve operative, buxheti i rishikuar 2.570.000 lekë dhe realizimi financiar 2.432.000 lekë, ose 95 % e buxhetit 2022.
- Subvencioni për HSH sha, buxheti i rishikuar 501,000 mijë lekë dhe realizimi financiar 501,000 mijë lekë, ose 100 % e buxhetit 2022.
- Fondi për transfertat buxhetore për familje e individë, buxheti i rishikuar është 568.000 lekë, dhe realizimi financiar në vlerën 397.000 lekë, ose 70 % e buxhetit të rishikuar.

Në total Shpenzimet korrente ne kete program janë realizuar në masën 100% e buxhetit 2022

Shpenzimet Kapitale me Financim të Brendshëm

Për vitin 2022 paraqitet kjo situatë:

- Për produktin “Sistem Hekurudhor i Reformuar”, ku përfshihet subvencioni për mbështetjen e hekurudhës, janë planifikuar 501 milion lekë dhe janë realizuar 501 milion lekë.
- Për produktin “Inspektime Hekurudhore të kryera” janë planifikuar 15,201 mijë lekë dhe janë realizuar 14.214 mijë lekë.
- Për produktin “Përmirësimi i infrastrukturës hekurudhore” janë të planifikuara investime në vlerën 49,464 mijë lekë dhe janë realizuar 49,229 mijë lekë për dy projektet:
 1. *Rikonstrukcion i linjës hekurudhore Milot – Lezhë, realizuar në 3,545 mijë lekë ose 100%.*
 2. *Riparim vepra arti, realizuar në 45,684 mijë lekë ose 99.5%*
- Për produktin “Rritja e disponibilitetit të mjeteve lëvizëse” janë planifikuar investime për vitin 2022 në vlerën 13,377 mijë lekë dhe janë realizuar 6.590 mijë lekë, ndarë sipas projekteve:
 1. *Paisje informatike për Hekurudha janë të planifikuara investime për vitin 2022, në vlerën 2.000 mijë lekë dhe është realizuar në shumën prej 1.886 mijë lekë.*
 2. *Për projektin “Rikonstrukcion i reparteve dhe linjave hekurudhore të NJSHML” janë planifikuara investime për vitin 2022, në vlerën 11.377 mijë lekë dhe është realizuar në shumën prej 4.703 mijë lekë.*
- Për TVSH e projekteve janë të planifikuara për vitin 2022 në vlerën 336,958 mijë lekë dhe janë realizuar 331,924 mijë lekë, sipas projekteve:

lekë

	Planifikuar	Realizuar
	336,958,253	331,924,281
TVSH për zbatimin e projektit "Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës - Tiranë dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore për në aeroportin e Rinasit"	301,871,231	301,871,231
TVSH Supervizioni i punimeve "Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës - Tiranë dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore për në aeroportin e Rinasit"	12,000,000	12,000,000
TVSh për hartimin e projektit të detajuar të linjës hekurudhore terminali i transportit publik - stacioni i trenit Tiranë (4km) si zgjatim i linjës hekurudhore Durrës - Tiranë	13,000,000	8,104,200
TVSH Hartimi i Projektit të detajuar Inxhinierik për Rehabilitimin e linjës hekurudhore "Vorë - Hani i Hotit (kufi me Malin e Zi)"	2,598,481	2,598,481
TVSH Promovimi i Intermodalitetit dhe Rilidhja Hekurudhore në Rajonin Adriatik-Jon	170,000	168,895
TVSH Studim i Prefisibilitetit për lidhjen hekurudhore Pogradec- Greqi [Kristalopigy]	3,210,000	3,153,589
TVSH IFRS - Standartizimi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar në Hekurudhat Shqiptare	2,508,541	2,508,541
TVSH Zhvillimi i Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social të Ndërtimit (CESMP) dhe Sistemeve të Menaxhimit Mjedisor dhe Social	1,600,000	1,519,344

Në total Shpenzimet Kapitale me Financim të Brendshëm në këtë program janë realizuar në masën 98.6% e buxhetit 2022

Shpenzimet Kapitale me Financim të Huaj

Me Aktin Normativ nr.17, datë datë 01.12.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"", të ndryshuar, shpenzimet kapitale me financim të huaj u pakësuan në shumën 263.000.000 lekë.

Plani i buxhetit me financim të huaj prej 1.695.349.000 lekë është realizuar 1.622.869.561 lekë ose 96 % e buxhetit 2022.

Emërtimi i Projektit	Plani i buxhetit viti 2022	REALIZIMI 2022
	1,695,349,000	1,622,869,561
-Supervizioni i punimeve "Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës - Tiranë dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore për në aeroportin e Rinasit"	88,751,000	60,000,000
-Hartimin e projektit të detajuar të linjës hekurudhore terminali i transportit publik - stacioni i trenit Tiranë (4km) si zgjatim i linjës hekurudhore Durrës - Tiranë	65,000,000	40,521,000
-Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës - Termali i pasagjerëve Tiranë dhe ndërtimi i linjës hekurudhore Tiranë - Rinas 1	737,748,920	762,296,627
-Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës - Termali i pasagjerëve Tiranë dhe ndërtimi i linjës hekurudhore Tiranë - Rinas 2	710,500,080	747,059,528
-Hartimi i Projektit preliminar Rrogozhinë-Pogradec-Lin (Kufi me Maqedoninë e Veriut)	15,000,000	
-Studim i Fisibilitetit dhe Projekt-ide për lidhjen hekurudhore Durrës - Prishtinë	19,000,000	
-Plani i Menaxhimit të Aseteve dhe Metodologjia e Tarifimit në Hekurudhat Shqiptare	30,000,000	
-Hartimi i Projektit të detajuar Inxhinierik për Rehabilitimin e linjës hekurudhore "Vorë - Hani i Hotit (kufi me Malin e Zi)"	17,000,000	12,992,406
-Hartimi i Projektit të detajuar Inxhinierik për Rehabilitimin e linjës hekurudhore Durrës Rrogozhinë	12,349,000	

PROGRAMI “TRANSPORTI AJROR“

Treguesit vjetor buxhetor për programin "Transporti Ajror", janë realizuar:

- Plani vjetor 2022, i rishikuar në vlerën 2,087,092,800 lekë
- Realizimi financiar vjetor, në vlerën 2,085,262,454 lekë, ose 100%

Shpenzimet Korrente

Në këtë program buxhetor janë përfshirë shpenzime për funksionimin e administratës së Organit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve Ajrore, në të cilat përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe mallra dhe shërbime, për mbarëvajtjen e funksionimit të kësaj strukture si dhe transfertat për Autoritetin e Aviacionit Civil.

Gjatë vitit 2022, buxheti i shpenzimeve korrente në nivel programi pësoi ndryshime buxhetore shtesa/pakësime si vijon:

- Me Aktin Normativ nr.3, datë 12.03.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2022", shpenzimet korrente, u pakësuan në vlerën 1,319,200 lekë.
- Me Aktin Normativ nr.12, datë 29.07.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2022", shpenzimet korrente, u pakësuan 4,000,000 lekë.
- Me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"", të ndryshuar, shpenzimet korrente u shtuan 2.000.000.000 lekë transfertë e brendshme për Autoritetin e Aviacionit Civil me qëllim mbulimin e projekteve në infrastrukturën ajrore dhe u pakësuan 5,000,000 lekë për shpenzime korrente të OKKIA.

Plani vjetor i shpenzimeve korrente, në vlerën 2,010,792,800 lekë, është realizuar në vlerën 2,009,030,905 lekë, ose 100%, sipas zërave:

- Shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime shoqërore), në vlerën 9,246,000 lekë, është realizuar në vlerën 8,068,726 lekë, ose 100%.
- Shpenzimet operative, në vlerën 2,001,496,800 lekë, janë realizuar në vlerën 2,000,912,179 lekë, ose 100%.
- Shpenzimet për fondin e veçantë në vlerën 50,000 lekë, janë realizuar në vlerën 50,000 lekë, ose 100%.

Shpenzimet Kapitale me Financim të Brendshëm

Zbatimi i projekteve për vitin 2022:

- Blerje e paisjeve dhe instrumentave pune + mobilim zyre OKIAA, nuk është kryer procedura e prokurimit dhe fondi prej 1.000.000 lekë u pakësua me Aktin Normativ nr.17 datë 01.12.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"", të ndryshuar, pasi OKIAA është në fazë ristrukturimi.
- Shërbime inxhinierike të pavarura për zbatimin e Kontratës Koncesionare/PPP "Për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e Aeroportit të Kukësit, Aktin Normativ nr.17 datë 01.12.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"", të ndryshuar, janë shtuar 5,100,000 lekë dhe janë realizuar në masën 100%.
- Kryerja e oponencës teknike të projektit, Për projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës, janë kryer shpenzimet e parashikuara në masën 100%.

PROGRAMI “FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIME”

Sektori i Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime është bazuar në realizimin e objektivave të mëposhtme:

- Mbulimi i plotë dhe me cilësi me shërbim të furnizimit me ujë në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërive UK dhe me prioritet:
 - Furnizimin me ujë të zonave urbane,
 - Zgjerimin dhe përmirësimin e furnizimit me ujë të zonave bregdetare.
- Mbulimin e kostos operative dhe rritja e performancës së ndërmarrjeve,
- Mbulimin me kanalizime dhe ITUN.

Qeveria Qëndrore me VKM nr.302, datë 11.05.2022 përcaktoi politikat e reja për riorganizimin e shoqërive U-K për përmirësimin e sektorit të ujësjellës kanalizimeve, për t'i mbështetur jo vetëm me anë të financimeve nga buxheti i saj, apo me financim të huaja për ndërtimin e infrastrukturës bazë të domosdoshme.

Shoqëritë e reja të krijuara do të mbartin të gjitha të drejtat dhe do të respektojnë marrëveshjet, detyrimet kontraktore, kontratat e shërbimit, si dhe çdo të drejtë/detyrim që rrjedh prej tyre, të nënshkruara ndërmjet Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve qendrore, shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve dhe ish-njësie të qeverisjes vendore me institucionet financiare ndërkombëtare dhe me shoqëritë kontraktuese.

Gjatë vitit 2022, buxheti në programin “Furnizimi me ujë dhe kanalizime” ka pësuar ndryshime me aktet normative të vitit 2022.

Konkretisht buxheti i shpenzimeve korrente dhe shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj, në nivel programi pësoi ndryshime buxhetore shtesa/pakësime si vijon:

- Me Aktin Normativ nr.3, datë 12.03.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2022"
 - Shpenzimet korrente, u pakësuan në shumën 5.052.000 lekë.
 - Financimi i brendshëm, u shtua në shumën 632.000.000 lekë.
 - Financimi i huaj, u pakësua në shumën 2.450.000.000 lekë.
- Me Aktin Normativ nr.12, datë 29.07.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"
 - Shpenzimet korrente, u pakësuan në shumën 5.000.000 lekë.
 - Financimi i huaj, u shtua në shumën 1.200.000.000 lekë.
- Me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"
 - Shpenzimet korrente, u pakësuan në shumën 9.001.000 lekë.
 - Financimi i brendshëm, u shtua në shumën 2.000.000.000 lekë.
 - Financimi i huaj, u pakësua në shumën 3.733.000.000 lekë.

Shpenzimet Korrente

- Paga (art.600), plani vjetor prej 45.250.000 lekë u realizua në vlerën 45.222.000 lekë ose 100% e planit të akorduar.
- Sigurime shoqërore (art.601), plani vjetor prej 8.208.000 lekë u realizua në vlerën 7,586.000 lekë ose 92 % e planit të akorduar.
- Mallra dhe Shërbime të tjera (art.602), plani vjetor prej 21.266.000 lekë u realizua në vlerën 12.204.000 lekë ose 58 % e planit të akorduar.
- Subvencione për ndërmarrjet/sha.ujësjellës kanalizime (art.603), plani vjetor prej 360,000.000 lekë u realizua për subvencion për Sh.a. U-K në vlerën 360,000.000 lekë ose 100% e planit të akorduar.
- Transport për Buxhet, Familjar dhe Individë (art.606), plani vjetor prej 694.000 lekë u realizua në vlerën 685.000 lekë ose 99% e planit të akorduar.

Shpenzimet Kapitale me Financim të Brendshëm

Për studime, projektim dhe oponencë teknike (art.230) për vitin 2022 janë planifikuar 124,651.000 lekë dhe janë financuar 124,651.000 lekë, ose 100% të planit të akorduar.

Për investime me financim të brendshëm, TVSH dhe KL (art.231) për vitin 2022 janë planifikuar 8,361,534.000 lekë dhe janë financuar 8,303,575.000 lekë ose 99% e planit të akorduar.

Sipas produkteve rezulton:

Investimet buxhetore për rezultatin A/I: Ujësjellës i ri

Për investimet në këtë kategori produktesh plani i rishikuar i vitit 2022 është në vlerën 5,164,304.000 lekë dhe është realizuar financimi në vlerën 5,132,342.000 lekë ose 99% e planit të akorduar.

Investimet buxhetore për rezultatin A/II: Rikonstrukcion Ujësjellësi

Për investimet në këtë kategori produktesh plani i rishikuar i vitit 2022 është në vlerën 1,536,352.000 lekë dhe është realizuar financimi në vlerën 1,523,693.000 lekë ose 99% e planit të akorduar.

Investimet buxhetore për rezultatin A/III: Kanalizimi i ri

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit buxhetor të rishikuar të vitit 2022 janë planifikuar 739,066.000 lekë dhe është realizuar financimi 726,524.000 lekë ose 98 % e planit të akorduar.

Investimet buxhetore për rezultatin A/IV: Rikonstrukcion KUZ

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit buxhetor të rishikuar të vitit 2022 janë planifikuar 83,889.000 lekë dhe është realizuar financimi 83,656.000 lekë ose 100% e planit të akorduar.

Investimet buxhetore për rezultatin A/V: I.T.U.P

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit buxhetor të rishikuar të vitit 2022 janë planifikuar 80,650.000 lekë dhe është realizuar financimi 80,200.000 lekë ose 99% e planit të akorduar.

Investimet buxhetore për rezultatin A/VI: Konsulencë

Për shërbim konsulence sipas planit buxhetor të rishikuar të vitit 2022 janë planifikuar 124,651.000 lekë dhe është realizuar financimi 124,651.000 lekë ose 100% e planit të akorduar.

Shpenzimet Kapitale me Financim të Huaj

Për konsulencë (art.230) për vitin 2022 janë planifikuar 59,168.000 lekë dhe janë financuar 53,788.000 lekë, ose 91% e planit të akorduar.

Për investime (art.231) për vitin 2022 janë planifikuar 1,627,106.000 lekë dhe janë financuar 1,139,398.000 lekë ose 70% të planit të akorduar.

Realizimi sipas Produkteve:

Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/I: Ujësjetës I ri

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit të rishikuar të vitit 2022 janë planifikuar 1,102,168.000 lekë dhe janë realizuar 858.314.000 lekë ose 78% e planit të akorduar.

Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/II: Kanalizimi i ri

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit të rishikuar të vitit 2022 janë planifikuar 1,062,354.000 lekë dhe janë realizuar 818,500.000 lekë ose 77 % e planit të akorduar.

Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/III: Impianti i Trajtimin të Ujrave të Zeza

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit të rishikuar të vitit 2022 janë planifikuar 209,228.000 lekë dhe janë realizuar 209,115.000 lekë ose 100 % e planit të akorduar.

Investimet me Financim të Huaj për rezultatin B/IV: Konsulencë

Për investimet në këtë kategori produktesh sipas planit të rishikuar të vitit 2022 janë planifikuar 69,797.000 lekë dhe janë realizuar 64,416.000 lekë ose 92 % e planit të akorduar.

PROGRAMI “MBËSHTETJE PËR ENERGJINË”

Fondet buxhetore të planifikuara në programin "Mbështetje për Energjinë", përgjithësisht janë fonde buxhetore në mbështetje të politikave në fushën e Eficencës së Energjisë.

Buxheti total për këtë program është në vlerën 23.822.218.123 lekë dhe realizimi është 21.781.154.000 lekë ose 91.4 %.

Gjatë vitit 2022 buxheti i shpenzimeve korrente dhe shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj, në nivel programi pësoi ndryshime buxhetore shtesa/pakësime si vijon :

- Me Aktin Normativ nr.3, datë 12.03.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2022"
 - Shpenzimet korrente u pakësuan në shumën 3,217.000 lekë.

- Me Aktin Normativ nr.12, datë 29.07.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"
 - Shpenzimet korrente u shtuan në shumën 78.000.000 lekë.
- Me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022":
 - Shpenzimet korrente u pakësuan në shumën 2.820.000 lekë.
 - Financimi i brendshëm u shtua në shumën 1.302.000.000 lekë.
 - Financimi i huaj u pakësua në shumën 613.000.000 lekë.

Gjithashtu gjatë vitit 2022 shpenzimet kapitale me financim të brendshëm u shtuan në zbatim të Vendimeve të Këshillit të Ministrave, për mbështetjen e sektorit energjitik:

- VKM nr.498, datë 29.07.2022 “Për kalim fondi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për mbështetjen e sektorit energjitik, faza e parë”, në vlerën 8.000.000.000 lekë.
- VKM nr.603, datë 14.09.2022 “Për kalim fondi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për mbështetjen e sektorit energjitik, faza e dytë”, në vlerën 8.000.000.000 lekë.
- VKM nr.875, datë 27.12.2022 “Për kalim fondi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për mbështetjen e sektorit energjitik, faza e tretë”, në vlerën 4.000.000.000 lekë.

Shpenzimet Korrente

Në shpenzimet korrente të këtij programi, janë përfshirë shpenzime personeli si dhe shpenzime operative për institucionet buxhetore Agjencia Kombëtare e Energjive Bërthamore (AKOB) dhe Agjencia e Efiçencës së Energjisë (AEE) të cilat kanë si objektiv hartimin dhe implementimin e projekteve në fushën e energjisë si dhe monitorimin e projekteve në varësi të tyre duke nxitur diversifikimin e burimeve energjitike dhe për të promovuar uljen e konsumit të energjisë nëpërmjet realizimit të masave të efiçencës, si dhe fondet për pagesat e avokatëve të kontraktuar për përfaqësimin dhe mbrojtjen e arbitrazhit ndërkombëtar kundër Republikës së Shqipërisë.

Plani i miratuar për vitin 2022, për shpenzimet korrente të programit është 127,990,600 lekë, dhe realizimi financiar është në vlerën 126,494,255 lekë, ose 99 % e planit e realizuar.

Shpenzimet korrente për vitin 2022, janë realizuar si më poshtë:

- Fondi për *paga*, planifikuar 22.513.000 lekë dhe realizuar 22.397.000 lekë ose 99.5%.
- Fondi për *sigurime shoqërore*, planifikuar 3.680.000 lekë dhe realizuar 3.680.000 lekë, ose 100%.
- Fondi për *shpenzimet operative*, planifikuar 100.984.000 lekë dhe realizuar 100.082.000 lekë ose 99.1%.
- Fondi për *transferta buxhetore për familje e individë*, planifikuar 815.000 lekë dhe realizuar 335.000 lekë ose 41.1%.

Shpenzimet Kapitale me Financim të Brendshëm

Buxheti vjetor për financimin e brendshëm inancimin e brendshëm i rishikuar, për programin "Mbështetje për Energjinë", është në vlerën 21,527,227,770 lekë dhe realizimi financiar është në vlerën 21,514,677,529 lekë ose 100% e realizuar dhe konkretisht:

Realizimi i objektivave buxhetore të programit janë planifikuar dhe realizuar produktet si më poshtë vijon:

- ❖ Produkti *“Akordim i kështit-it të parë, për mbulimin me likujditet të veprimtarisë operacionale të shoqërisë KESH”* në bazë të Vendimit nr.498, datë 29.07.2022 *“Për Kalim Fondi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për mbështetjen e Sektorit Energjitik”*, për të cilin është kryer pagesa sipas transhit të parë të akorduar realizuar në masën 100%.
- ❖ Produkti Akordim i Transhit të dytë dhe i tretë për mbulimin me likujditet të veprimtarisë operacionale të shoqërisë KESH, realizuar në masën 100%.
- ❖ Produkti Transferim Kapital për ALBGAS SH.A, realizuar në masën 100%.
- ❖ Produkti *“Monitorime në sektorin Energjitik”*, realizuar nga AKBN ka në përbërjen e tij 2 nënprodukte të planifikuar në shumën 5,921,000 lekë dhe realizuar 100%.
- ❖ Produkti *“Studime për përmirësimin e sektorit energjitik, përmirësimin e efikasitetit të energjisë, zhvillimin e burimeve të rinovueshme”*, realizuar nga AKBN dhe AEE, ka në përbërjen e tij 23 nënprodukte (studime) të planifikuara për tu realizuar gjatë vitit 2022 për të cilat është planifikuar fondi prej 164.015.140 lekë, nga të cilat janë realizuar 18 produkte në vlerën 163.734.888 lekë ose 99.8 %.
- ❖ Produkti *“Ndërtim/Rikonstruksion”*, ka në përbërjen e tij 14 nënprodukte për të cilat është planifikuar fondi prej 96.298.800 lekë, nga të cilat për vitin 2022 janë realizuar 5 nënprodukte në vlerën 94.103.000 lekë ose 97.8%.
- ❖ Produkti *“TVSH + Kosto Lokale për projektet në fushën e energjisë” (për projektet që ndiqen nga AKBN, AEE dhe Aparati MIE)*, ka në përbërjen e tij 16 nënprodukte për të cilat është planifikuar fondi prej 61.492.730 lekë, nga të cilat vitin 2022 janë realizuar 10 nënprodukte në vlerën 50.918.641 lekë ose 83% e buxhetit 2022 për këtë produkt.

Në projektet me financim të brendshëm, janë përfshirë projekte studimore në fushën e auditimit energjetik, rinovimit të ndërtesave me efikasitet energjetike, instalimit të ndriçimit me efikasitet të lartë dhe përdorimin e energjiave të rinovueshme. Këto projekte janë implementuar nga Agjencia për Efikasitetin e Energjisë, lidhur me:

- Promovimin e Efikasitetit të Energjisë në sektorin e ndërtesave duke pasur si qëllim përmirësimin e kushteve të komfortit të ambienteve të brendshme të banimit, në përputhje me standardet mjedisore dhe shëndetësore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi si dhe sensibilizimi i popullatës nëpërmjet demonstrimit në praktikë të ndërhyrjeve për përmirësimin e efikasitetit të energjisë.

- Promovimin e Eficencës së Energjisë në sektorin e Transportit ku objektivi kryesor është ofrimi i infrastrukturës për stacionet e karikimit të makinave elektrike gjithashtu dhe pemëve fotovoltaike si një mënyrë për nxitjen e elektrifikimit të transportit rrugor, i cili është dhe ndotësi kryesor i CO₂ në Shqipëri. Kjo do të ndikonte drejtpërsëdrejti në uljen e emetimeve dhe arritjen e objektivave të përcaktuara në Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën.

Shpenzimet Kapitale me Financim të Huaj

Për investimet me financim të huaj sipas planit të rishikuar të vitit 2022 janë planifikuar 2.167.000.000 lekë lekë. Në përfundim të periudhës raportuese janë realizuar 139.982.040 lekë ose 6 % e planit të akorduar.

në lekë

	Planifikuar	Realizuar	
	2,167,000,000	139,982,040	<u>Komente</u>
Projekti PRO - ENERGY	18,100,000	4,010,620	Projekti është në zbatim.
Projekti REEHUB “Efikasiteti Rajonal i Energjisë”	0	0	Projekti ka përfunduar.
PROJEKTET GAMES TARGE TBLEU DEAL SME.EC dhe Re-Source	1,900,000	9,110,060	Projektet (Games TargeT, BLEU DEAL, Seadrion Plus dhe Re-Source) kanë implementim të ulët në vitin 2022, për arsye të vlerës së vogël të TVSH dhe Kostos Lokale që nuk lejojnë pagesën e kontraktorit.
Projekti REHUB + “Efikasiteti Rajonal i Energjisë”	7,450,000	4,159,790	Projekti ka përfunduar.
Mbështetje vazhdimësisë për nismën për transparencë në industrinë nxjerrëse EITI	40,000,000	0	Projekti ka përfunduar.
"Bashkëpunimi Greqi Shqipëri për ndërtesat me konsum zero, (Greece cOllaborates with ALbania for nZEBS,)"	9,890,000	8,008,510	Projekti është në zbatim të kontratës së punimeve "Masat e integruara të energjisë në qendrën e kulturës Fato Berberi, Gjirokastër".
Projekti GATE	0	3,724,234	Projekti ka përfunduar kontratën e punimeve "Masat e integruara të energjisë në shkollën fillore Së bashku, Gjirokastër" në 2022.
Rehabilitimi i Qytetit Studenti No.2	0	21,113,486	Projekti është realizuar për të tre fazat dhe ka përfunduar në dhjetor 2021, dy pagesa nga ana e donatorit janë realizuar në janar 2022.
Konvikte të rinovuara me eficecne të energjisë Qyteti Studentit nr 1 Programi i Rehabilitimit të Konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas Parimit të Eficencës së Energjisë (Faza I, Faza II, Faza III, fond shtesë)	972,400,000	23,897,270	Projekti është në proces, në zbatim të kontratës "Shërbim Konsulence" Ishte parashikuar të lidhej kontrata me kontraktorin e punimeve civile brenda vitit 2022, proces i cili u finalizua në janar 2023.
Projekti për mbështetje në sektorin energjetik	648,038,000	0	Projekti ka përfunduar në vitin 2021.

Programi i Investimeve për Shpërndarjen e Energjisë Elektrike I (Kredi)	326,622,000	56,995,343	<i>Projekti është në Zbatim</i>
Programi i Investimeve për Shpërndarjen e Energjisë Elektrike I (Grant)	32,600,000	8,962,727	<i>Projekti është në Zbatim</i>
Rehabilitimi i rrjetit elektrik Himarë - Dhërmi	100,000,000	0	<i>Priten ndryshime në marrëveshje</i>
Rehabilitimi i Hidrocentralit të Fierzës (DKTI)	10,000,000	0	<i>Marrëveshja ka hyrë në fuqi në muajin Gusht 2022. KESH ka filluar procedurat për përzgjedhjen e konsulentit të zbatimit të projektit. Punimet rehabilituese planifikohen të fillojnë në Qershor 2023.</i>

PROGRAMI “MBËSHTETJE PËR BURIMET NATYRORE”

Objektivat e programit buxhetor "Mbështetje për Burimet Natyrore", janë realizuar në:

- Promovimin e burimeve të pashfrytëzuara të mineraleve të kromit, bakrit dhe ranor silicor, vlerësimi sasior dhe cilësor i rezervave minerare, hartimi i studimeve dhe projekteve gjeologjike, studimi dhe vlerësimi i pasurive natyrore të lëndëve hidroenergjetike. Vlerësimin e rreziqeve gjeologjike mbi qëndrueshmërinë e truallit dhe infrastrukturës publike në shkallë vendi dhe vlerësime emergjente. Mirëadministrimi i territorit në shkallë vendi, nëpërmjet përpilimit të hartave gjeologjike, gjeomjedisore gjeomonumenteve.
- Shfrytëzimi me efikasitet i burimeve natyrore minerare nga shoqëritë e licensuara për këtë veprimtari nëpërmjet zbatimit të kushteve tekniko - profesionale dhe mjedisore sipas standarteve europiane.
- Rritja e transparencës në industrinë nxjerrëse, me qëllim rritjen e cilësisë në mirëqeverisjen e industrisë nxjerrëse.

Fondet buxhetore të realizuar në nivel programi "Mbështetje për Burimet Natyrore", përgjithësisht janë fonde buxhetore në mbështetje të politikave në fushën e menaxhimit të burimeve natyrore, si vijon:

Plani i rishikuar për vitin 2022, në vlerën 402,141,000 lekë, realizimi financiar në vlerën 398,309,00 lekë ose 99%.

Shpenzimet korrente

Plani vjetor i rishikuar për vitin 2022, është 264,141,000 lekë dhe realizimi financiar është 261,415,000 lekë, ose rreth 99% e realizuar.

Gjatë vitit 2022, buxheti i shpenzimeve korrente në nivel programi pësoi ndryshime buxhetore shtesa/pakësime si vijon :

- Me Aktin Normativ nr.12, datë 29.07.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"", të ndryshuar, shpenzimet korrente u reduktuan me 5,000,000 lekë, në zërin e shpenzimeve të paga dhe sigurime shoqërore, për njësitë shpenzuese Shërbimin Gjeologjik Shqiptar dhe Agjencinë Kombëtare të Sigurisë së Emergjencave në Miniera.
- Me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"", të ndryshuar, shpenzimet operative u shtuan me 52,000,000 lekë për likuidimin e shpenzimeve administrative të çështjes së arbitrazhit.
- Me Aktin Normativ nr.19, datë 29.12.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"", të ndryshuar, si dhe VKM-në nr. 898, datë 29.12.2022, "Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës", shpenzimet e personelit për paga dhe sigurime shoqërore janë pakësuar në vlerën 1,710,000 lekë, për të planifikuar fonde për ndihmen e menjëhershme financiare, sipas njësive shpenzuese të programit.

Detajimi i shpenzimeve korrente sipas zërave paraqitet :

- Shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime shoqërore) janë realizuar në masën 99%.
- Shpenzimet operative, janë realizuar në masën 98%.
- Shpenzime për transferta familjare, janë realizuar në masën 96%.

Shpenzimet Kapitale me Financim të Brendshëm

Në projektet me financim i brendshëm, janë realizuar investimet për projektet studimore në fushën minerare, të monitorimit të subjekteve minerare të licensuar në fushën e shfrytëzimit minerar, studimeve gjeologjike, gjeofizike, hidrologjike. Projektet e investimeve janë implementuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Sigurisë së Emergjencave në Miniera dhe ndërmarrjet në konservim Albakër sh.a, Albakrom sh.a, Albminierat sh.a.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, sipas planit vjetor të rishikuar, janë në vlerën 138,000,000 lekë dhe realizimi financiar është 136,894,000 lekë ose 99%, ku janë realizuar projektet si vijon :

- Projekti "Përditësim gjeohapsinor i të dhënave të lejeve minerare"
- Projekti "Azhornimi gjeohapsinor i hapësirave që krijohen nga shfrytëzimi minerar nëntokësor"
- Projekti "Mbikqyrja e shfrytëzimit të burimeve minerare metalore dhe jometalore"
- Projekti "Promovimi i mineraleve të rinj dhe kërkimet teknologjike e mjedisore"
- Projekti "Studim mbi zonimin minerar dhe hartimi i planit vjetor dhe 3-vjekar minerar"
- Projekti "Raport vjetor mbi gjëndjen mjedisore në industrinë minerare dhe metalurgji"
- Projekti "Monitorimi i fenomeneve të postshfrytëzimit në minierat e mbyllura"
- Projekti "Raport mbi industrinë nxjerrëse në Shqipëri",

- Projekti "Automjete për inspektim dhe emergjencë"
- Projekti "Paisje dhe aparatura për grupin e inspektim shpëtimit"
- Projekti "Paisje kompjuterike dhe sigurim me kamera"
- Projekti "Aparatura e paisje teknologjike pune e paisje pune profesionale"
- Projekti "Paisje kompjuterike"

Për ndërmarrjet në likuidim "Abminiera", "Albkrom", "Albbakër" sh.a, fondet buxhetore janë realizuar në masën 100%, për likuidimin e pagave, sigurimeve shoqërore të punonjësve, detyrime tatimore dhe ndaj të tretëve.

PROGRAMI “MBËSHTETJE PËR INDUSTRIJË”

Treguesit vjetor buxhetor për programin "Mbështetje për Industrinë", janë realizuar:

- Plani vjetor 2022, i rishikuar në vlerën 325,615,972 lekë
- Realizimi financiar vjetor, në vlerën 318,402,596 lekë, ose 97.7%

Shpenzimet Korrente

Gjatë vitit 2022, buxheti i shpenzimeve korrente në nivel programi pësoi ndryshime buxhetore shtesa/pakësime si vijon:

- Me Aktin Normativ nr.3, datë 12.03.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2022", shpenzimet korrente, u pakësuan në vlerën 10,128,500 lekë.
- Me VKM-në nr. 898, datë 29.12.2022, "Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës", shpenzimet e personelit për paga dhe sigurime shoqërore, u shtuan në vlerën 584,472 lekë, për të planifikuar fonde për ndihmën e menjëhershme financiare, sipas njësive shpenzuese.

Plani vjetor i shpenzimeve korrente, në vlerën 267,615,972 lekë, është realizuar në vlerën 267,595,546 lekë ose 100%, sipas zërave:

- Shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime shoqërore), në vlerën 227,521,972 lekë, është realizuar në vlerën 227,521,972 lekë, ose 100%.
- Shpenzimet operative, në vlerën 39,894,000 lekë, janë realizuar në vlerën 39,873,574 lekë, ose 100%.
- Shpenzimet për fondin e veçantë në vlerën 2,350,000 lekë, janë realizuar në vlerën 2,350,000 lekë, ose 100%.

Shpenzimet Kapitale me Financim të Brendshëm

Realizim i investimeve sipas produkteve paraqitet si me poshtë:

- Produkti 1 “Hartim projekti per zonat industriale” fondi i parashikuar 1,000 mijë lekë, u pakësua me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022.
- Produkti 2 “Buletin informativ për Industrinë” fondi i planifikuar 700 mijë lekë, u pakësua me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022.
- Produkti 3 “Implementimi i sistemit të hidranteve të depove sipas standarteve” fondi i planifikuar 500 mijë lekë, u pakësua me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022.
- Produkti 4 “Blerje mjet transporti për kimikate” fondi i planifikuar 2,819 mijë lekë është realizuar 100%.
- Produkti 5 “Blerje paisje profesionale pune” fondi i planifikuar 284 mijë lekë është realizuar 100%.
- Produkti 6 “Aparatura Laboratorike për treguesit cilësor të naftës dhe gazit” planifikuar 27,240 mijë lekë, u pakësua me aktin normativ nr.17 dt 01.12.2022. Plani i rishikuar 11,564 mijë lekë u realizua 9,564 mijë lekë, pasi aparaturat e planifikuara janë blerë me çmime më të lira se ato të planifikuara në projekt. Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara pranë MB që zhvillon dhe procedurat pavarësisht se me shkresën e mbërritur nga MIE me nr. prot 9345/14, datë 21.12.2022 “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.17 datë 01.12.2022”, ISHTI-t i janë pakësuar fondet, ka njoftuar për shpalljen fituesin dhe lidhjen e kontratës në Janar 2023, për blerje që ishin parashikuar me fondet e pakësuara.
- Produkti 7 “Aparatura laboratorike tekstili” planifikuar 5,000 mijë lekë. Me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022, u pakësua me 986 mijë lekë. Plani i rishikuar 4,014 lekë nuk u realizua pasi kontrata e lidhur në muajin nëntor u anulua për moszbatim të kushteve të saj.
- Produkti 8 “Laborator Lëvizës dhe aparatura” fondi i planifikuar 4,500 mijë lekë. Me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022, u pakësua me 3.500 mijë lekë. Plani i rishikuar 1,000 mijë lekë nuk u realizua pasi është në proces ankimimi në KPP.
- Produkti 9 “Konservim Azotiku Fier”, fondi i planifikuar 6,000 mijë lekë është realizuar 5,856 mijë lekë, në masën 98%.
- Produkti 10 “Monitorim landfilli” fondi i planifikuar 500 mijë lekë është realizuar 465 mijë lekë, në masën 93%.
- Produkti 11 “Konservim Prodhim Çeliku Elbasan” fondi i planifikuar 31,819 mijë lekë, është realizuar 100%.

PROGRAMI “MBËSHTETJE PËR RRJETET E KOMUNIKACIONIT”

Treguesit vjetor buxhetor për programin "Mbështetje për rrjetet e komunikacionit", për vitin 2022, janë realizuar:

- Plani vjetor 2022, i rishikuar në vlerën 24,000,000 lekë

Shpenzimet Kapitale me Financim të Brendshëm dhe të Huaj

Gjatë vitit 2022, buxheti i shpenzimeve kapitale në nivel programi pësoi pakësime si vijon:

- Me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", shpenzimet kapitale me financim të brendshëm u pakësuan në vlerën 3,000,000 lekë dhe shpenzimet kapitale me financim të huaj u pakësuan në vlerën 20,000,000 lekë.

Sipas projekteve situata paraqitet:

1. WB22-ALB-DII-02 Projekti Pilot, Asistencë Teknike për zhvillimin e Broadband-it në zonat rurale (Shkodër, Kukës, Tropojë, Dibër - pjesë të programit "100 villages"), grant me vlerë 700,000 Euro, në kuadër të WBIF-23;
2. WB24-ALB-DII-01 asistencës teknike "Detajim Teknik për zhvillimin e broadband-it në zonat e bardha (Bashkia Vlorë, Gjirokastrë, Fier, Berat, Korçë)", grant me vlerë 800,000 Euro.

Projektet sa më sipër, kanë filluar me vonesë, në 31.12.2021 është dorëzuar "Inception Report" ku rekomandohet bashkimi i dy projekteve "Jugu dhe Veriu" duke rishikuar vlerën totale të grantit si dhe fushave dhe aktivitetet e tjera të përfshira. Në vijim pritët miratim nga WBIF.

Për sa më sipër, financim i brendshëm për të mbuluar TVSH-në e projekteve "Asistencë teknike - Projekti pilot 1 - për zonën e veriut" dhe "Asistencë Teknike - Projekti pilot 2 - për zonën e Jugut" për vitin 2022 nuk u realizua.

3. "Zhvillimi Rajonal i Broadband -Asistencë teknike- Projekti i Atlasit të Broadband", grant me vlerë 250, 000 Euro.

Ky projekt ka filluar në 17.02.2022, dhe ka përfunduar në dhjetor 2022. Për këtë projekt ishin miratuar si financim i huaj 5.000.000 lekë për vitin 2022 dhe financim i brendshëm 1.000.000 lekë. Fondi i parashikuar nga financimi i brendshëm për rimbursim të kostove lokale/TVSH nuk është përdorur, pasi konsulentët kanë informuar që nuk kanë kërkesë/fatura për rimbursim të TVSH.

PROGRAMI "PLANIFIKIMI URBAN"

Treguesit vjetor buxhetor për programin "Planifikimi Urban", janë realizuar:

- Plani vjetor 2022, i rishikuar në vlerën 101,402,141 lekë
- Realizimi financiar vjetor, në vlerën 96,634,854 lekë, ose 95.2%

Shpenzimet Korrente

Gjatë vitit 2022, buxheti i shpenzimeve korrente në nivel programi pësoi ndryshime buxhetore shtesa/pakësime si vijon:

- Me Aktin Normativ nr.3, datë 12.03.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2022", shpenzimet korrente, u pakësuan në vlerën 3,094,286 lekë.
- Me Aktin Normativ nr.12, datë 29.07.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2022", shpenzimet korrente, u pakësuan 5,000,000 lekë.
- Me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"", të ndryshuar, shpenzimet korrente, u pakësuan 4,000,000 lekë.

Plani vjetor i shpenzimeve korrente, në vlerën 56,402,141 lekë, është realizuar në vlerën 54,579,704 lekë, ose 96.7%, sipas zërave:

- Shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime shoqërore), në vlerën 44,730.741 lekë, është realizuar në vlerën 43,094.900 lekë ose 96.3%.
- Shpenzimet operative, në vlerën 10,880,400 lekë, janë realizuar në vlerën 10,878,602 lekë ose 100%.
- Shpenzimet për fondin e veçantë në vlerën 791,000 lekë, janë realizuar në vlerën 607,202 lekë ose 76.7%.

Shpenzimet Kapitale me Financim të Brendshëm

Gjatë vitit 2022, buxheti i shpenzimeve korrente në nivel programi pësoi ndryshime buxhetore pakësime me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e vitit 2022", shpenzimet kapitale me financim të brendshëm u pakësuan në vlerën 49.000.000 lekë.

Për programin "Planifikim Urban" janë parashikuar, në total 45 milion lekë, nga të cilat 2.56 milion për ASHSH, 31.4 milion për projektet që ndjek Aparati i MIE dhe 11 milion lekë për Shpronësime të Bashkisë Fier dhe Bashkisë Vlorë në zbatim të Vendimeve përkatëse për këtë qëllim.

Zbatimi i projekteve për vitin 2022:

- Projekti "Hartimi i Planeve të Përgjithshme Vendore" planifikuar 21,766 mijë lekë, është realizuar prej 21,162 mijë lekë ose në masën 97%.
- Projekti "Paisje elektronike" ASHSH, planifikuar 1,061 mijë lekë është realizuar në masën 100%.
- Projekti "Pajisje mobilje zyre" për ASHSH, planifikuar 1,200 mijë lekë është realizuar prej 1,051 mijë lekë ose në masën 88%.
- Projekti "Blerje program financiar" për ASHSH, planifikuar 300 mijë lekë është realizuar në masën 100%.
- Për projektin "Hartimi i Standardeve të projektimit të spitaleve dhe klinikave mjekësore" planifikuar 9, 673 mijë lekë, është realizuar në masën 100%.
- Për projektin "Shpronësim në zbatim të VKM nr.125, datë 03.03.2021 për Bashkinë Fier", planifikuar 11,000 mijë lekë dhe realizuar prej 8,808 mijë lekë ose në masën 80%.

Sqarojmë se të dhënat faktike lidhur me shpenzimet korrenete dhe shpenzimet kapitale me financim të brendshëm rakordojnë me Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ). Ndërsa të dhënat lidhur me shpenzimet kapitale me financim të huaj janë gjeneruar sipas raportimit të njësive zbatuese të projekteve pranë strukturave përgjegjëse të MIE.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Viola Haxhiademi

Konceptoi: A. Bareti

Miratoi: E. Mamaj

